

Drejtues të rektoratit të Ugj-së zhvilluan një vizitë zyrtare në Universitetin e Salentos, Lecce, Italy.

Takimet u zhvilluan në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy universiteteve.

Gjatë takimit me rektorin e Universitetit të Salentos Fabio Pollice, rektori i UGJ, prof.dr. Bektash Mema vuri theksin mbi shtrirjen e bashkëpunimeve rajonale edhe ndërmjet njësive kryesore për projekte të përbashkëta kërkimore në fusha me interes të përbashkët.

Në takim u diskutua edhe mbi ecurinë e programit të përbashkët "Digital Management" i cili është aplikuar dhe është në procesin e vlerësimit nga MAS.



